



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 28.3.2018**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 4, shkronja “dh”, nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 4 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”, miratuar me vendimin nr. 37, datë 25.06.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 1, shkronja “e” ndryshon me përmbajtje si vijon:

*“një ose më shumë përfaqësues në nivel ekzekutiv nga ministrinë, të cilat mbulojnë funksionet në vijim, në cilësinë e anëtarit:*

- i. thesarin e shtetit;*
- ii. të drejtën për të propozuar akte ligjore të hartuara nga Banka e Shqipërisë;*
- iii. mbrojtjen e konsumatorit;*
- iv. regjistrin e gjendjes civile;*
- v. luftën kundër krimit kibernetik;*
- vi. inovacionin dhe dixhitalizimin e shërbimeve publike (e-government);*
- vii. dërgesat e emigrantëve;*
- viii. si dhe funksione të tjera të cilat në varësi të objektivave dhe projekteve mund të ndërlidhen me funksionin e Komitetit.”;*

b) Në nenin 4, shkronjat “f”, “g” dhe “h” shfuqizohen;

c) Në nenin 4, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me përmbajtje si më poshtë:

*“një përfaqësues në nivel ekzekutiv nga institucionet financiare jobanka, të cilat kryejnë veprimtarinë e transfertave dhe pagesave dhe/ose të parasë elektronike dhe operatorët e infrastrukturës, të licencuar në bazë të ligjit “Për Sistemin e Pagesave”, në cilësinë e Anëtarit; përfaqësuesit mund të marrin pjesë në mbledhje me përfaqësim ose në formë individuale.”;*

d) Në nenin 4, pika 3 ndryshon me përmbajtje si vijon:

*“Në mbledhjen e Komitetit, në varësi të tematikave të përcaktuara në rendin e ditës, mund të marrin pjesë si vëzhgues aktorë të tjerë kryesorë të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare të tillë si: shoqëritë utilitare, shoqëritë e telekomunikacionit, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, ekspertë të huaj të fushës së sistemeve apo shërbimeve të pagesave etj.”;*

e) Në nenin 4, pika 4, adresa elektronike e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave“ ndryshon nga [“komiteti@bankofalbania.org”](mailto:komiteti@bankofalbania.org) në [“komitetiKSP@bankofalbania.org”](mailto:komitetiKSP@bankofalbania.org);

f) Në nenin 6, pika 1 ndryshon me përmbajtje si vijon:

*“Komiteti mbledhet si rregull të paktën 1 herë në vit, si dhe me kërkesë të anëtarëve me të drejtë vote, të përcaktuar në nenin 4, pika 1, sa herë gjykohet e nevojshme.”*

2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**